

K u s h j a m u n ë ?

Mësimet e Ramana Maharshit

Përkthyer nga Ridvan Bunjaku

!:(!:)

Qershor 2018

Kush jam unë?

Mësimet e Bhagavan Sri Ramana Maharshit

Përkthimi në anglisht nga

Dr. T. M. P. MAHADEVAN

nga origjinali që është në gjuhën Tamil



Botuar nga

V. S. RAMANAN

PRESIDENT, BOARD OF TRUSTEES

SRI RAMANASRAMAM

TIRUVANNAMALAI, S. INDIA

HYRJE

“Kush jam unë?” është titulli që i është dhënë një grupi të pyetjeve dhe të përgjigjeve në lidhje me Shqyrtimin e Vetes. Pyetjet iu bënë Bhagavan Sri Ramana Maharshi-t nga Sri M. Sivaprakasam Pillai rreth vitit 1902. Sri Pillai, i diplomuar në Filozofi, në atë kohë ishte i punësuar në Sektorin e të Ardhurave të Komunës së Arcot-it Jugor. Gjatë vizitës së tij në Tiruvannamalai më 1902 në punë zyrtare, shkoi në Shpellën Virupaksha në Kodrën Arunachala dhe e takoi Mjeshtrin aty. Nga ai kërkoi udhërrëfim shpirtëror, dhe përgjigje për pyetjet në lidhje me Shqyrtimin e Vetes. Meqë në atë kohë Bhagavan-i nuk fliste, jo për shkak të ndonjë betimi të bërë, por sepse nuk kishte dëshirë të fliste, iu përgjigj me gjepte pyetjeve të bëra, dhe kur këto nuk kuptoheshin, me të shkruar. Siç u kujtuan dhe u regjistruan nga Sri Sivaprakasam Pillai, ishin katërmëdhjetë pyetje me përgjigje të dhëna nga Bhagavan-i. Ky regjistrim u botua fillimisht nga Sri Pillai më 1923, bashkë me disa poema të krijuara nga vetë ai që flisnin për mënyrën si mirësia e Bhagavan-it funksiononte në rastin e tij duke i tretur dyshimet e tij dhe duke e shpëtuar nga një krizë në jetë. ‘Kush jam unë?’ është botuar disa herë më pas. Në disa botime i gjejmë tridhjetë pyetje dhe përgjigje, dhe në të tjera — njëzet e tetë. Është edhe një version tjetër i botuar në të cilin nuk janë dhënë pyetjet, dhe mësimet janë rirregulluar në formë të esesë. Përkthimi ekzistues anglisht është i kësaj eseje. Përkthimi aktual është i tekstit në formë të njëzet e tetë pyetjeve dhe përgjigjeve.

Bashkë me “Vicharasangraham”-in (“Shqyrtimi i Vetes”), “Nan Yar” (“Kush jam unë?”) e përbën grupin e parë të udhëzimeve në fjalët e vetë Mjeshtrit. Këto dyja janë të vetmet vepra në prozë ndër Punimet e Bhagavan-it. Ato e shpjegojnë qartë mësimin qendror se rruga e drejtpërdrejtë e çlirimit është Shqyrtimi i Vetes. Mënyra e hollësisht se si duhet të bëhet shqyrtimi është shpjeguar kthjelltësisht në Nan Yar. Mendja përbëhet nga mendimet. Mendimi ‘unë’ është i pari që shfaqet në mendje. Kur shqyrtimi ‘Kush jam unë?’ ndiqet në vazhdimësi, të gjitha mendimet e tjera shkatërrohen, dhe përfundimisht vetë mendimi ‘unë’ zhduket duke e lënë të vetme Vetën supreme. Kështu, identifikimi i rremë i Vetes me fenomenet e jo-vetes siç është trupi dhe mendja — përfundon, dhe ndodh përndritje, Sakshatkara. Procesi i shqyrtimit, natyrisht, nuk është i lehtë. Gjersa njeriu shqyrton ‘Kush jam unë?’, do të shfaqen mendime të tjera; por gjersa shfaqen, njeriu nuk duhet t’iu jepet duke i ndjekur, përkundrazi, duhet të pyesë: ‘Kujt i shfaqen ato?’. Për ta bërë këtë, personi duhet të jetë jashtëzakonisht vigjilent. Përmes shqyrtimit të vazhdueshëm personi duhet ta bëjë mendjen të rrijë në burimin e vet, pa e lejuar të brezhë larg dhe të humbet në labirintet e mendimit të krijuar nga vetja. Të gjitha disiplinat e tjera si kontrolli i frymëmarrjes dhe meditimi për format e Zotit duhet të shikohen si praktika ndihmëse. Ato janë të dobishme deri në masën që i ndihmojnë mendjes të bëhet e prehur dhe e fokusuar në një pikë.

Për mendjen që ka fituar shkathhtësi në përqendrim, Shqyrtimi i Vetes bëhet relativisht i lehtë. Pikërisht përmes shqyrtimit të pareshtur shkatërrohen mendimet dhe njihet Vetja — Realiteti absolut në të cilin nuk ka madje as mendim ‘unë’, përjetimi të cilit i referohemi si “Qetësi”.

Ky, në thelb, është mësimi i Bhagavan Sri Ramana Maharshi-t në “Nan Yar” (“Kush jam unë?”).

Universiteti i Madras-it – 30 qershor 1982

Përshëndetje për Bhagavan Sri Ramana Maharshi-n

Kush jam unë?

(Nan Yar?)

Meqë të gjitha qeniet e gjalla kanë merak të jenë gjithmonë të lumtura, pa mjerim; meqë te secili është vërejtur dashuria supreme për veten e vet; dhe meqë lumturia, e vetme, është shkaku për dashuri — për ta fituar atë lumturi që është natyra e personit dhe që përjetohet në gjendjen e gjumit të thellë kur nuk ka mendje, personi duhet ta njohë veten. Për këtë, rruga e njohjes, shqyrtimi në formën “Kush jam unë?”, është mënyra kryesore.

1. *Kush jam unë?*

Trupi i dendur që përbëhet nga shtatë pëlhurat (dhatus) — nuk jam; pesë organet shqisore njohëse, dmth. shqisa e dëgjimit, e prekjes, e të pamurit, e shijimit dhe e nuhatjes, që i kapin objektet e veta përkatëse, dmth. zërin, prekjën, ngjyrën, shijen dhe aromën — nuk jam; pesë organet njohëse shqisore, dmth. organet e të folurit, të lëvizjes, të të kuptuarit, të sekretimit, dhe të riprodhimit, që i kanë si funksione përkatëse të folurit, lëvizjen, të kuptuarit, sekretimin, dhe kënaqësinë — nuk jam; pesë ajret vitale, prana, etj., që i kryejnë përkatësisht pesë funksionet e frymë-marrjes, etj. — nuk jam; madje as mendja e cila mendon — nuk jam; as mosnjohja, që pajiset vetëm me përshtypjet e mbetura të objekteve, dhe në të cilën nuk ka objekte dhe as funksionime — nuk jam.

2. *Nëse nuk jam asnjëra nga këto, atëherë kush jam?*

Pas heqjes së të gjitha të lart-përmendurave si ‘jo kjo’, ‘jo kjo’, ajo Vetëdije që mbetet e vetme — ajo jam.

3. *Çfarë është natyra e Vetëdijes?*

Natyra e Vetëdijes është ekzistencë-vetëdijesi-lumturi supreme [sat-chit-ananda].

4. *Kur do të arrihet njohja e Vetes?*

Kur bota që është ajo-që-shihet të jetë hequr, do të ketë njohje të Vetes e cila është pamësi (ai-ajo që sheh).

5. *A nuk do të ketë njohje të Vetes edhe gjersa bota është aty (e marrë si reale)?*

Nuk do të ketë.

6. *Pse?*

Pamësi dhe objekti i parë [i pamë] janë si litari dhe gjarpri. Siç nuk do të shfaqet njohja e litarit i cili është baza pa u larguar njohja e rreme e gjarprit iluzor, ashtu nuk do të arrihet njohja e Vetes e cila është baza pa u hequr besimi se bota është reale.

7. *Kur do të hiqet bota që është objekti i parë [i pamë]?*

Kur mendja, që është shkaku i tërë njohurisë dhe i të gjitha veprimeve, bëhet e prehur, bota do të zhduket.

8. *Çfarë është natyra e mendjes?*

Ajo që quhet 'mendje' është fuqi mahnitëse që rri në Vetën. Ajo shkakton të shfaqen të gjitha mendimet. Jashtë mendimeve, nuk ka diçka të tillë si mendja. Prandaj, mendimi është natyra e mendjes. Jashtë mendimeve, nuk ka entitet të pavarur të quajtur 'bota'. Në gjumë të thellë nuk ka mendime, dhe nuk ka botë. Në gjendjet e zgjimit dhe të ëndrrës, ka mendime, dhe ka edhe botë. Sikur merimanga që e nxjerr fijen (e rretës) nga vetja dhe prapë e tërheq në vete, njësoj mendja e projekton botën përjashta nga vetja dhe prapë e tret në veten. Kur mendja del nga Vetja, shfaqet bota. Prandaj, kur bota duket (të jetë e vërtetë), Vetja nuk duket; dhe kur Vetja duket (ndriçon), bota nuk duket. Kur personi e shqyrton vazhdimisht natyrën e mendjes, mendja do të përfundojë duke e lënë Vetën (si mbetje). Ajo që i referohemi si Vetja është Atman-i. Mendja ekziston gjithmonë vetëm në varësi të diçkaje të dendur; nuk mund të rrijë vetëm. Është mendja ajo që quhet trupi subtil apo shpirti (jiva).

9. *Cila është rruga e shqyrtimit për ta kuptuar natyrën e mendjes?*

Ajo që shfaqet si 'unë' në këtë trup është mendja. Nëse personi shqyrton se ku shfaqet së pari në trup mendimi 'unë', do ta zbulonte se shfaqet në zemër. Ai është vendi i zanafillës së mendjes. Edhe nëse personi mendon vazhdimisht 'unë' 'unë', do të drejtohet tek ai vend. Nga të gjitha mendimet që shfaqen në mendje, mendimi 'unë' është i pari. Vetëm pas shfaqjes së tij shfaqen mendimet e tjera. Vetëm pas shfaqjes së përemrit të parë vetor shfaqen përemrat e dytë dhe të tretë vetorë; pa përemrin e parë vetor nuk do të ketë të dytë dhe të tretë.

10. *Si do të bëhet e prehur mendja?*

Përmes shqyrtimit ‘Kush jam unë?’. Mendimi ‘kush jam unë?’ do t’i shkatërrojë të gjitha mendimet e tjera, dhe si dega që përdoret për ta përzier turrën e ndezur të druve, do të shkatërrohet vetë në fund. Pastaj, do të shfaqet njohja e Vetes.

11. *Cila është mënyra për ta mbajtur vazhdimisht mendimin ‘Kush jam unë?’*

Kur shfaqen mendime të tjera, personi nuk duhet t’i ndjekë, por duhet të shqyrtojë: ‘Kujt i shfaqen ato?’ Nuk ka rëndësi se sa mendime shfaqen. Gjersa shfaqet secili mendim, personi duhet të shqyrtojë me zell: ‘Kujt i është shfaqur ky mendim?’. Përgjigja që do të dilte do të ishte “Mua”. Pas kësaj nëse personi shqyrton “Kush jam unë?”, mendja do të kthehet te burimi i vet; dhe mendimi që u shfaq do të bëhet i prehur. Me praktikë të përsëritur në këtë mënyrë, mendja do ta zhvillojë shkathtësinë të rrijë në burimin e vet. Kur mendja që është subtile del jashtë përmes trurit dhe organeve shqisore, shfaqen emrat dhe format e dendura; kur ajo rri në zemër, emrat dhe format zhduken. Moslënia e mendjes të dalë jashtë, por mbajtja e saj në Zemër është ajo që quhet “kah-brendësi” (përbrendësi, antar-mukha). Lënia e mendjes të dalë jashtë Zemrës njihet si “përgjashtësim” (bahir-mukha). Kështu, kur mendja rri në Zemër, ‘uni’ që është burimi i të gjitha mendimeve do të largohet, dhe Vetja — që ekziston gjithmonë — do të shkëlqejë. Çkado që bën personi, duhet ta bëjë pa egoitetin “unë”. Nëse personi vepron në atë mënyrë, gjithçka do të duket si e natyrës së Siva-s (Zotit).

12. *A nuk ka mënyra të tjera për ta bërë mendjen të prehur a?*

Përveç shqyrtimit, nuk ka mënyra të përshtatshme. Nëse përmes mënyrave të tjera kërkohet të kontrollohet mendja, mendja do të duket se po kontrollohet, por prapë do të shkojë tutje. Edhe përmes kontrollit të frymëmarrjes, mendja do të bëhet e prehur; por do të jetë e prehur vetëm gjersa frymëmarrja mbetet e kontrolluar, dhe kur frymëmarrja rifillon edhe mendja do të nisë prapë të lëvizë dhe do të bredhë siç nxitet nga përshtypjet e mbetura. Burimi është i njëjti edhe për mendjen edhe për frymëmarrjen. Mendimi, në të vërtetë, është natyra e mendjes. Mendimi ‘unë’ është mendimi i parë i mendjes; dhe ky është egoitet [unësi]. Prej aty ku zë fill egoiteti, zë fill edhe frymëmarrja. Prandaj, kur mendja bëhet e prehur, fryma kontrollohet, dhe kur fryma kontrollohet, mendja bëhet e prehur. Por në gjumë të thellë, edhe pse mendja bëhet e prehur, frymëmarrja nuk ndalet. Kjo është për shkak të vullnetit të Zotit, ashtu që trupi të mund të mbahet gjallë dhe njerëzit e tjerë të mos e kenë përshtypjen se është i vdekur. Në gjendjen e zgjimit dhe në samadhi, kur mendja bëhet e prehur — kontrollohet frymëmarrja. Frymëmarrja është forma e dendur e mendjes. Deri në kohën e vdekjes, mendja e mban frymëmarrjen në trup; dhe kur trupi vdes mendja e merr

frymëmarrjen me vete. Prandaj, ushtrimi i kontrollit të frymëmarrjes është vetëm ndihmë për ta bërë mendjen të prehur (manonigraha); ai nuk do ta shkatërrojë mendjen (manonasa).

Sikur praktika e kontrollit të frymëmarrjes, meditimi për format e Zotit, përsëritja e mantrave, frenimi në ushqim, etj., janë veçse ndihma për ta bërë mendjen të prehur.

Përmes meditimit për format e Zotit dhe përmes përsëritjes së mantrave, mendja bëhet e fokusuar në një pikë. Mendja do të jetë gjithmonë duke bredhur. Sikur kur një vargua i jepet një elefanti që ta mbajë me feçkën e vet — ai do të lëvizë duke e shtrënguar vargoin dhe asgjë tjetër, po kështu kur mendja preokupohet me një emër apo formë, do ta kapë vetëm atë. Kur mendja zgjerohet në formën e mendimeve të panumërta, secili mendim bëhet i dobët; por gjersa mendimet treten mendja bëhet e fokusuar në një pikë dhe e fortë; për mendjen e tillë Shqyrtimi i Vetes do të bëhet i lehtë. Nga të gjitha rregullat kufizuese, ajo që lidhet me marrjen e ushqimit satvvic në sasi të matura është më e mira; duke e zbatuar këtë rregull, cilësia satvvic-e e mendjes do të rritet, dhe kjo do të jetë e dobishme për Shqyrtimin e Vetes.

13. Përshtypjet e mbetura (mendimet) e objekteve duket sikur lëkundën si valët e një oqeani. Kur do të shkatërrohen të gjitha ato?

Gjersa meditimi për Vetën ngritet lart e më lart, mendimet do të shkatërrohen.

14. A është e mundur që përshtypjet e mbetura të objekteve që vijnë nga koha e pafillim, në një farë mënyre, të treten, dhe që personi të mbetet si Vetja e pastër?

Pa iu dhënë dyshimit “A është e mundur, apo jo?”, personi duhet t’i mbahet në vazhdimësi meditimit mbi Vetën. Madje edhe në qoftë mëkatar i madh personi, nuk duhet të shqetësohet e të vajtojë “Oh! Jam mëkatar, si mund të shpëtohem?”; ai duhet ta braktisë plotësisht mendimin “Jam mëkatar”; dhe të përqendrohet fort në meditimin mbi Vetën; pastaj, ai do t’ia dilte sigurisht. Nuk janë dy mendje—një e mirë dhe tjetra e keqe; mendja është vetëm një. Përshtypjet e mbetura janë ato që janë të dy llojeve — të mbara dhe të pambara. Kur mendja është nën ndikimin e përshtypjeve të mbara quhet e mirë; dhe kur është nën ndikimin e përshtypjeve të pambara konsiderohet si e keqe.

Mendja nuk duhet të lejohet të bredhë kah objektet materiale dhe kah ajo që i shqetëson njerëzit e tjerë. Sado të këqij qofshin njerëzit e tjerë, personi nuk duhet të ketë urrejtje për ta. Edhe merak [dëshira e fortë] edhe urrejtja duhet të shmangen. Të gjitha ato që personi ua jep të tjerëve, ia jep vetes. Nëse kjo e vërtetë kuptohet kush nuk do t’iu japë të tjerëve? Kur vetja e personit ngritet — gjithçka ngritet; kur vetja e personit bëhet e prehur — gjithçka bëhet e prehur. Në masën që sillemi me barazi [modesti], në atë masë do të jetë rezultati i mirë. Nëse mendja bëhet e prehur, njeriu mund të jetojë kudo.

15. *Për sa kohë duhet të praktikohet shqyrtimi?*

Për sa të ketë përshtypje të objekteve në mendje, për aq kohë kërkohet shqyrtimi “Kush jam unë?”. Gjersa mendimet shfaqen, duhet të shkatërrohen atëherë dhe aty mu në vendin e zanafillës së vet, përmes shqyrtimit. Nëse personi i mbahet vëzhgimit të Vetes pandërprerë, deri kur të arrihet Vetja, kjo — e vetme — do të funksionojë. Sa të ketë armiq brenda kalasë, do të vazhdojnë të turren në sulm; nëse shkatërrohen gjersa shfaqen, kalaja do të bie në duart tona.

16. *Çfarë është natyra e Vetes?*

Ajo që ekziston në të vërtetën është Vetja, e vetme. Bota, shpirti individual dhe Zoti janë pamje në të. Si argjendi në perlën e sedefitë, këto tria shfaqen në të njëjtën kohë, dhe zhduken në të njëjtën kohë. Vetja është ajo ku absolutisht nuk ka mendim ‘unë’. Kjo quhet “Qetësi”. Vetë Vetja është bota; vetë Vetja është “uni”; vetë Vetja është Zot; gjithçka është Siva, Vetja.

17. *A nuk është gjithçka veprë e Zotit?*

Pa ndonjë merak, vendim, apo përpjekje, dielli lind; dhe në prezencën e vet të thjeshtë, guri diellor rrezaton zjarr, lotusi çel, uji avullon; njerëzit kryejnë funksione të ndryshme dhe pastaj pushojnë. Siç lëviz gjilpëra në prezencën e magnetit, ashtu — thjesht për shkak të prezencës së Zotit — shpirtrat e qeverisur nga tri funksionet (kozmiqe) të aktivitetit të pesëfishtë hyjnor i kryejnë veprimet e veta dhe pastaj pushojnë, në pajtim me karmat e tyre përkatëse. Zoti nuk ka vendim; asnjë karma nuk i ngjitet Atij. Kjo është si veprimet tokësore që nuk ndikojnë te dielli, apo si cilësitë dhe të metat e katër elementeve të tjera që nuk ndikojnë në hapësirën gjithë-përshkuese.

18. *Nga besimtarët, kush është më i madhi?*

Ai që i jepet Vetes — e cila është Zot — është besimtari më i shkëlqyeshëm. T’i jepesh Zotit domethënë të mbetesh vazhdimisht në Vetën pa i dhënë hapësirë shfaqjes së asnjë mendimi tjetër pos atij të Vetes. Çfarëdo ngarkesa që i hidhen Zotit, Ai i mban. Meqë fuqia supreme e Zotit i bën të gjitha gjërat të lëvizin, pse do të duhej ne, pa iu nënshtruar asaj [fuqie], të shqetësohemi vazhdimisht me mendimet se çka duhet të bëhet dhe si, dhe çka nuk duhet të bëhet dhe si nuk duhet? E dimë se treni i bart të gjitha ngarkesat, prandaj pasi të futemi në të pse do të duhej ta bartnim bagazhin tonë të vogël në kokën tonë duke na sjellë parehati, në vend se ta lëshojmë në tren dhe të ndihemi të çlodhur?

19. *Çka është jo-ngjitja?*

Gjersa shfaqen mendimet, shkatërrimi i tyre plotësisht pa ndonjë mbetje mu në vendin e zanafillës së tyre është jo-ngjitje. Sikur zhytësi i perlave që e lidh një gur për belin e vet, kridhet në fund të detit dhe atje merr perla, ashtu secili nga ne duhet të pajiset me jo-ngjitje, të zhytet brenda vetes dhe ta marrë Perlën e Vetes.

20. *A nuk është e mundur që Zoti dhe Guru-ja [udhëheqësi shpirtëror] ta shkaktojnë çlirimin e një shpirti?*

Zoti dhe Guru-ja vetëm do ta tregojnë rrugën kah çlirimi; ata vetë nuk do ta çojnë shpirtin te gjendja e çlirimit. Në të vërtetën, Zoti dhe Guruja nuk janë të ndryshëm. Siç nuk ka shpëtim gjahu që ka rënë në kthetrat e tigrin, ashtu ata që kanë ardhur brenda zonës së shikimit të mirësishëm të Guru-së do të shpëtohen nga Guru-ja dhe nuk do të humben; e prapë, secili duhet që me përpjekje të vet ta ndjekë rrugën e treguar nga Zoti apo nga Guru-ja dhe ta arrijë çlirimin. Njeriu mund ta njohë veten vetëm me syrin e vet të njohjes, dhe jo me të dikujt tjetër. A kërkon ai që është Rama ndihmë të pasqyrës për ta ditur që ai është Rama?

21. *A është e nevojshme për njeriun që e do shumë çlirimin ta shqyrtojë natyrën e kategorive (tattva-ve)?*

Siç nuk ka nevojë ai që dëshiron ta gjuajë bërlllokun — ta analizojë dhe të shohë se çka është, ashtu — ai që dëshiron ta njohë Vetën — nuk ka nevojë ta numërojë numrin e kategorive apo t'i shqyrtojë karakteristikat e tyre; ajo çka duhet të bëjë ai është t'i flakë tërësisht kategoritë që e fshehin Vetën. Bota duhet të konsiderohet si ëndërr.

22. *A nuk ka dallim ndërmjet gjendjes zgjuar dhe ëndrës a?*

Gjendja zgjuar është e gjatë dhe ëndërra e shkurtër; pos kësaj nuk ka dallim. Siç duken reale ngjarjet në gjendjen zgjuar gjersa jemi zgjuar, ashtu duken ato në ëndërr gjersa ëndërrojmë. Në ëndërr mendja e merr një trup tjetër. Në të dy gjendjet — zgjuar dhe në ëndërr — mendimet, emrat dhe format ndodhin njëkohësisht.

23. *A sjell ndonjë dobi leximi i librave për ata që e duan shumë çlirimin?*

Të gjitha tekstet thonë se për ta arritur çlirimin njeriu duhet ta bëjë mendjen të prehur; prandaj mësimi i tyre vendimtar është se mendja duhet të bëhet e prehur; pasi të jetë kuptuar kjo nuk ka nevojë për lexim të pafundëm. Për ta qetësuar mendjen njeriu vetëm duhet të shqyrtojë brenda vetes se çka është Vetja e vet; si do të mund të bëhej ky

kërkim në libra? Njeriu duhet ta njohë Vetën e vet me syrin e vet të urtisë. Vetja është brenda pesë shtresave; por librat janë jashtë tyre. Meqë Vetja duhet të shqyrtohet duke i hedhur pesë shtresat, është e kotë që ajo të kërkohet në libra. Do të vijë një kohë kur njeriut do t'i duhet t'i harrojë të gjitha ato që i ka mësuar.

24. Çka është lumturia?

Lumturia është vetë natyra e Vetes; lumturia dhe Vetja nuk janë të ndryshme. Nuk ka lumturi në asnjë objekt të botës. Përmes paditurisë sonë imagjinojmë se lumturinë e nxjerrim nga objektet. Kur mendja del jashtë, përjeton mjerim. Në të vërtetë, kur merakët e saj përmbushen, ajo kthehet në vendin e vet dhe e shijon lumturinë që është Vetja. Ngjashëm, në gjendjet e gjumit, samadhi dhe kur na bie të fikët, dhe kur objekti që e kemi merak sigurohet apo objekti i papëlqyer hiqet, mendja bëhet e kthyer përbrenda, dhe e shijon Vetë-Lumturinë e pastër. Kështu mendja lëviz pa pushim me radhë duke dalë jashtë Vetes dhe duke u kthyer tek ajo. Nën pemë hija është e këndshme; jashtë në ambient të hapur nxehtësia është përcëlluese. Personi që ka qenë në diell ndien freski kur e arrin hijen. Dikush që vazhdon të shkojë nga hija në diell dhe pastaj kthehet në hije është budalla. Njeriu i urtë rri përherë në hije. Ngjashëm, mendja e atij që e di të vërtetën nuk e lë Brahman-in. Mendja e të paditurit, përkundrazi, vërtitet nëpër botë, duke u ndier e mjerë, dhe për pak kohë kthehet te Brahman-i për të përjetuar lumturi. Në fakt, ajo që quhet bota është vetëm mendim. Kur bota zhduket, dmth. kur nuk ka mendim, mendja përjeton lumturi; dhe kur bota shfaqet, ajo kalon nëpër mjerim.

25. Çka është intuita urtake (jnana-drsti)?

Të qëndruarit i qetë është ajo që quhet intuitë urtake. Të rri i qetë është ta tretësh mendjen në Vetën. Telepatia, dija e ngjarjeve në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen dhe komunikimi me shpirtat e të vdekurve nuk përbëjnë intuitë urtake.

26. Çfarë është lidhja ndërmjet pamerakësisë dhe urtisë?

Pamerakësia është urti. Ato dyja nuk janë të ndryshme; janë e njëjta. Pamerakësia është të përmbajturit nga kthimi i mendjes kah cilido objekt. Urtia domethënë mos-shfaqja e asnjë objekti. Me fjalë të tjera mos-kërkimi i asaj që është tjetër nga Vetja është shkëputje apo pamerakësi; mos-lënia e Vetes është urti.

27. Cili është dallimi ndërmjet shqyrtimit dhe meditimit?

Shqyrtimi qëndron në mbajtjen e mendjes në Vetën. Meditimi qëndron në të menduarit se vetja e njeriut është Brahman, ekzistencë-vetëdijesi-lumturi supreme.

28. Çka është çlirimi?

Shqyrtimi i natyrës së vetes së personit e cila është në robëri, dhe njohja e natyrës së vërtetë të njeriut është çlirim.

Online

<https://botimetr.com/>

Licencimi

Ky publikim lëshohet nën licencën



Attribution-NonCommercial-ShareAlike

CC BY-NC-SA

This license lets others remix, tweak, and build upon your work non-commercially, as long as they credit you and license their new creations under the identical terms.

që nënkupton se i lejon të tjerët ta shkarkojnë dhe ta shpërndajnë te të tjerët, ta ndryshojnë punën në mënyrë jokomerciale, përderisa e përmendin burimin dhe i licencojnë krijimet e reja nën terma identike. Për më tepër, shih:

<http://creativecommons.org/licenses/>